

VENDIM
Nr.35, datë 27.10.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,		
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Bashkim Dedja	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 14.9.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. Akti, që i përket:

KËRKUESE: Luiza Melengu, përfaqësuar nga avokat Denis Selimi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Zyra e përmbarimit, TIRANË, në mungesë.

Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, përfaqësuar nga Erjon Kafazi me autorizim.

OBJEKTI: 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.917, datë 20.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

2. Detyrimi i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar të ekzekutojë këtë vendim, të dëmshpërblejë dëmin financiar për vonesën e pagesës dhe dëmin jofinanciar në shumën 3 000 euro si dhe të paguajë kostot dhe shpenzimet në shumën 3 000 euro.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 132/1, 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenet 6 e 41 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut, nenet 27 e 28 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin përfaqësuesin e kërkueses Luiza Melengu që kërkoi pranimin e kërkesës dhe përfaqësuesin e subjektit të interesuar: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr.917, datë 20.6.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur pranimin e pjesës së paditës Luiza Melengu, detyrimin e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) të paguajë në favor të kërkueses 3 paga mujore në masën 3 x 51645 lekë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës; 2 paga mujore në masën 2 x 51645 lekë si dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, sipas nenit 144 të Kodit të Punës; shpërblimin për vjetërsi pune në masën 6.5 muaj, duke iu referuar pagës së paditës; rrëzimin e padisë për pjesën tjetër si të pabazuar në ligj e në prova.

Më datë 15.7.2008, ky vendim gjyqësor ka marrë formë të prerë.

Me vendimin nr.154, datë 10.09.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur lëshimin e urdhrat ekzekutiv për vendimin civil nr.917, datë 20.6.2008 të kësaj Gjykate.

2. Zyra e përmbarimit Berat ka vërejtur se nuk ishte kompetente për ekzekutimin e titullit

ekzekutiv dhe ia ka dërguar aktet Zyrës së Përmbartimit Tiranë. Kjo e fundit nuk ka mundur të ekzekutojë vendimin, duke u shprehur se INUK ka mungesë fondesh.

Zyra e përmbartimit ka informuar Gjykatën Kushtetuese me shkresën nr. prot. 7492, datë 11.5.2010 se çështja përmbartimore është transferuar nga Zyra e Përmbartimit Berat në datën 2.10.2009 dhe në zbatim të titullit ekzekutiv janë kryer këto veprime:

- Lajmërim për ekzekutim vullnetar me nr. 14149 prot. i datës 13.11.2008, bazuar në nenin 517 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile.

- Kërkesë për ekzekutim të titujve ekzekutivë me nr.7772 prot. e datës 3.5.2009.

- Kërkesë për ekzekutim të titujve ekzekutivë me nr.14790 prot. e datës 1.10.2009.

- Kërkesë për ekzekutim të titujve ekzekutivë me nr.6589 prot. të datës 27.4.2010.

3. Zyra e përmbartimit informon Gjykatën Kushtetuese se Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar ka kthyer në shumicën e rasteve përgjigje, duke u justifikuar me mungesën e fondeve, se INUK-u kishte në gjendje vetëm 5 milionë lekë dhe se me këtë shumë do të ekzekutoheshin në masën 66 % vetëm vendime për 17 kreditorë, duke i marrë sipas radhës së daljes së vendimeve të gjykatave dhe se në fillim të vitit të ardhshëm do të procedohej me diferencat dhe me pjesën tjetër.

4. Kërkesja pretendon përpara Gjykatës Kushtetuese se:

- i është cenuar e drejta e saj, e mbrojtur nga neni 6/1 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ) për një gjykim të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm. E drejta që i është njohur asaj me vendimin nr.917, datë 20.6.2008 mbetet iluzive, pasi vendimi gjyqësor i formës së prerë nuk është veprues, në dëm të kërkujeses. Vonesat në ekzekutimin e vendimit gjyqësor mund të justifikohen në rrethana të caktuara, por nuk mund të jenë të tilla që të cenojnë thelbin e së drejtës që garanton neni 6/1 i Konventës;

- janë shkelur nenet 534 dhe 535 të Kodit të Procedurës Civile dhe se detyrimi ndaj kërkujeses duhej të ishte shlyer në mënyrë proporcionale ndërmjet të gjithë kreditorëve.

5. Subjekti i interesuar, INUK-u, parashtroi se:

- INUK-u është institucion juridik publik në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit dhe mbulohet 100 për qind nga Buxheti i Shtetit. Ky institucion ka kërkuar nga organet eprore financiare përkatëse çeljen e fondeve për shlyerjen e detyrimeve të lindura nga urdhrat e ekzekutimit;

Për vitin 2009 INUK-ut iu miratua shuma 5 000 000 lekë për detyrimet dhe kompensimet ligjore, nga të cilat u shlyen 18 kreditorë;

Për vitin 2010 INUK-u ka kërkuar çeljen e një fondi me vlerë 10 000 000 lekë për shlyerjen e detyrimeve të mbetura;

- INUK nuk e ka vënë në asnjë çast në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe ka marrë masa për përmbushjen e tyre. Por INUK-u është i kufizuar në burimet financiare që ka në dispozicion. Ndaj dhe vonesa në ekzekutim është e justifikuar në këto rrethana të veçanta që kanë të bëjnë me pamjaftueshmërinë dhe mosçeljen në kohë të shpejtë të fondeve nga organet përkatëse;

- kërkesa e kërkujeses, që Gjykata Kushtetuese të detyrojë INUK-un, që të ekzekutojë vendimin gjyqësor, nuk duhet të merret në shqyrtim nga kjo gjykatë, pasi nuk përfshihet në kompetencën e saj sipas nenit 132 pika 1 të Kushtetutës.

- kërkesja nuk legjitimohet në pjesën e kërkesës për dëmshpërblimin financiar që INUK-u duhet të kryejë ndaj kërkujeses, për shkak të mosezaurimit të mjeteve të tjera ligjore e kushtetuese.

II

A. Lidhur me pretendimin se kërkujeses i është cenuar e drejta për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

6. Fillimisht Gjykata Kushtetuese vlerëson çështjen e legjitimitetit të kërkujeses lidhur me këtë pretendim. Gjykata çmon se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, pasi sipas nenit 134 shkronja “g” të Kushtetutës, individët mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që lidhen me interesat e tyre. Kërkesja legjitimohet *ratione temporis*, pasi objekt i kërkesës është mosekzekutimi i një vendimi të formës së prerë, si edhe *ratione materiae*, pasi kërkesa e paraqitur hyn në juridiksionin

e Gjykatës Kushtetuese në pjesën e shprehur në objektin e kërkesës: “Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.917, datë 20.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat”.

7. Në shumë raste, Gjykata Kushtetuese është shprehur se nenet 42, 142/3 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj. Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të KEDNJ-së (*shih vendimet nr.27, datë 20.6.2007; nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*vendimi nr.6, datë 31.3.2006; nr.6, datë 6.3.2009 i Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata ka vlerësuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata është shprehur edhe më parë se autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor (*shih vendimin nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.43, datë 19.12.2007*).

9. Lidhur me ekzekutimin e vendimeve brenda afatit të arsyeshëm, edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) shprehet se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, si pjesë e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, është element i procesit të rregullt gjyqësor sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, të gjitha shtetet detyrohen të organizojnë sistemin juridik në mënyrë të tillë që gjykatat të mundësojnë shqyrtimin e të gjitha çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, sepse sistemi i drejtësisë nuk mund të zhvillohet me vonesa që çojnë në dobësimin e rolit të gjykatave dhe të besimit në to (*shih çështjen Bageta kundër Italisë, vendim i datës 25.06.1998 i GJEDNJ-së*). GJEDNJ ka sqaruar se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe kur ai ekzekutohet (*shih çështjen Giralanci kundër Italisë, vendim i datës 19.02.1999 i GJEDNJ-së*), dhe se faza e ekzekutimit duhet të llogaritet, pra të konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtut proces (*shih çështjen Vakaturro kundër Italisë, vendim i datës 25.05.1991 i GJEDNJ-së*). Gjykata ka konfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e kërkuar. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, vëllimin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*vendimi “Cravcenko kundër Moldavisë”, datë 15.4.2008 i GJEDNJ-së*).

10. Gjykata Kushtetuese, me qëllim analizimin e sjelljes së palëve në dritën e standardeve kushtetuese në çështjen objekt shqyrtimi, merr në konsideratë edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC) lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore. Këto dispozita sqarojnë procedurat ligjore, të cilat duhen plotësuar për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

11. Neni 451/a (paragrafi i parë) i KPC-së parashikon se vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Neni 510 i KPC-së parashikon se ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv dhe se janë tituj ekzekutivë, ndër të tjera, vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë. Neni 511 parashikon se titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit dhe, për këtë qëllim, lëshohet urdhri i ekzekutimit nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 511 të KPC-së. Urdhri i

ekzekutimit vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor ndër të tjera edhe me kërkesën e kreditorit (neni 515). Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor mund të bëhet fillimisht me ekzekutim vullnetar. Kështu, neni 517 i KPC-së parashikon kriteret për lajmërimin për ekzekutim vullnetar sipas të cilit përmbaruesi gjyqësor, kur fillon ekzekutimin, i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 5 ditësh, kur objekti është pagë ose detyrim për ushqim, dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera. Neni 518 i KPC-së parashikon se lajmërimi duhet ndër të tjera të përmbajë paralajmërimin që i bëhet debitorit se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm në qoftë se urdhri i ekzekutimit nuk ekzekutohet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim. Neni 519 i KPC-së parashikon kriteret për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, i cili nuk mund të fillojë para se të kenë kaluar afatet e parashikuara në nenin 517. Neni 537 parashikon se kur shuma e nxjerrë nga ekzekutimi nuk mjafton për të paguar të gjithë kreditorët, përmbaruesi gjyqësor përgatit projektin e ndarjes, duke veçuar më parë shumat që nevojiten për kreditë që paguhen me preferim dhe nga pjesa tjetër që mbetet, paguan kreditë e tjera në përpjesëtim me shumat e tyre.

12. Në çështjen në shqyrtim, është e nevojshme të vlerësohet nëse zyra e përmbarimit Tiranë ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe, në këtë mënyrë, vlerësohet nëse veprimet ose mosveprimet janë në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë.

13. Zyra e përmbarimit ka informuar Gjykatën Kushtetuese se hapat proceduralë të ndërmarrë prej saj janë lajmërimi për ekzekutim vullnetar dhe tri kërkesa për ekzekutim të titujve ekzekutivë drejtuar INUK-ut, më e fundit e datës 27.4.2010. Zyra e përmbarimit më tej informon se INUK-u ka kthyer në shumicën e rasteve përgjigje se nuk ka mundësi të ekzekutojë vendimin gjyqësor duke u justifikuar me mungesën e fondeve.

14. Gjykata Kushtetuese vëren se nga rrethanat e çështjes rezulton që urdhri ekzekutiv i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat mban datën 10.9.2008. Pra, kanë kaluar rreth dy vjet nga data që ka dalë ky urdhër dhe ai ende nuk është zbatuar. Si është shprehur edhe më parë Gjykata Kushtetuese, mungesa e fondeve nuk përbën argument për të justifikuar mosekzekutimin e vendimit gjyqësor. Shpjegimet e parashtruara para Gjykatës nga zyra e përmbarimit dhe INUK-u lidhur me ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të kërkuases nuk e bindën Gjykatën se këto organe i kanë marrë të gjitha masat për të filluar, qoftë edhe pjesërisht, shlyerjen e detyrimit ndaj kërkuases, sipas parashikimeve të nenit 537 të KPC-së, ku thuhet se, kur shuma e nxjerrë nga ekzekutimi nuk mjafton për të paguar të gjithë kreditorët, përmbaruesi gjyqësor përgatit projektin e ndarjes, duke veçuar më parë shumat që nevojiten për kreditë që paguhen me preferim dhe, nga pjesa tjetër që mbetet, paguan kreditë e tjera në përpjesëtim me shumat e tyre. Ndaj Gjykata çmon se në rastin në shqyrtim nuk ka arsye të bazuara që të justifikojnë mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

B. Lidhur me pretendimin për dëmshpërblim

15. Gjykata çmon se sa i përket kërkesës së kërkuases, që Gjykata Kushtetuese të detyrojë INUK-un të ekzekutojë vendimin, të dëmshpërblejë dëmin financiar për vonesën e pagesës dhe dëmin jo financiar në shumën prej 3 000 euro dhe 3 000 euro për kostot dhe shpenzimet, kërkuësja nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për shkak se nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese e ligjore, parakusht ky i sanksionuar në nenin 131 shkronja "f" të Kushtetutës. Gjykata arrin në këtë përfundim, pasi mbrojtja juridike e kërimit të këtij dëmi në bazë të nenit 42 të Kushtetutës, të KC dhe të KPC realizohet me anë të ngritjes dhe gjykimin të padisë me një objekt të tillë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të pushtetit gjyqësor, të parashikuara nga neni 135 i Kushtetutës. Pas shterimit të këtyre mjeteve juridike individit, për mbrojtjen e kësaj të drejte, mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por kurdoherë që shkelja e të drejtës së tij kushtetuese të jetë e lidhur detyrimisht me një proces të parregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 49/2 e 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.917, datë 20.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Petrit Pllloçi, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Bashkim Dedja.